PUBLIC
Date original: 06/03/2025 16:13:00
Date translation: 30/09/2026 18:21:00

KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes:	**KSC-CC-2024-28**
Vendosi:	**Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese** Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës Gjykatës Rumen Nenkov Gjykatëse Romina Inkuti
Administratore:	Fidelma Donlon
Data:	6 mars 2025
Gjuha:	Anglishte
Titulli i dosjes:	Kërkesë Referuese e Haxhi Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese
Klasifikimi:	Publik

Vendim mbi Kërkesën Referuese të Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

---

Parashtruesit
Haxhi Shala

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

PUBLIC
Date original: 06/03/2025 16:13:00
Date translation: 30/09/2026 18:21:00

I. PROCEDURA....3
A. KËRKESA REFERUESE....3
B. PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE GJUHA E PUNËS....4
C. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE....4
II. FAKTET....4
A. ARRESTIMI DHE PARAQITJA E PARË E PARASHTRUESIT....5
B. RISHIKIMI I PARABURGIMIT....7
C. APELI I NDËRMJETËM....10
D. KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË....15
E. KËRKESA PËR RISHIKIM....17
III. SHKELJA E PRETENDUAR....19
IV. JURIDIKSIONI....19
V. KUADRI I SHQYRTIMIT....19
VI. PRANUESHMËRIA....21
VII. THEMELËSIA....22
A. ARGUMENTET E PARASHTRUESIT....22
B. VLERËSIMI I DHOMËS....23
C. PËRFUNDIM....31
VIII. KËRKESAT SHOQËRUESE....31

PUBLIC
Date original: 06/03/2025 16:13:00
Date translation: 30/09/2026 18:21:00

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

e përbërë nga

Vidar Stensland, Kryegjykatës

Rumen Nenkov, gjykatës

Romina Inkuti, gjykatëse

Pas kuvendimeve nga distanca, lëshon Vendimin e mëposhtëm

I. PROCEDURA

A. KËRKESA REFERUESE

1. Më 11 nëntor 2024, z. Haxhi Shala ("Parashtruesi") i paraqiti një Kërkesë Referuese Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (përkatësisht "Ligji" dhe "Kërkesa Referuese").[1] Parashtruesi përfaqësohej nga z. Tobi Kadman dhe z. Xhon Kabën.

2. Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi u ankua për një shkelje të të drejtave themelore në lidhje me arrestimin dhe paraburgimin e tij, të urdhëruar prej Dhomave të Specializuara ("DHS"). Në veçanti, Parashtruesi argumentoi se mosshqyrtimi prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake i ligjshmërisë dhe themelësisë së paraburgimit të tij, dhe marrja e vendimit për to në seancën e paraqitjes së parë të Parashtruesit më 13 dhjetor 2023, shkeli të drejtën e tij për liri dhe siguri sipas nenit 5(3) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa").[2]

3. Më 14 nëntor 2024, Kryetarja e DHS-së, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit caktoi

[1] KSC-CC-2024-28, F00001, Kërkesë Referuese e Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publike, 11 nëntor 2024.
[2] Kërkesa Referuese, para. 18-35, 36(i).

Panelin e lartpërmendur për të vendosur mbi Kërkesën Referuese.[3]

B. PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE GJUHA E PUNËS

4. Dhoma gjykoi se Kërkesa Referuese ishte mjaftueshëm e plotë dhe se nuk nevojiteshin parashtrime të tjera me shkrim sipas rregullës 15(2) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK-së").[4]

5. Gjithashtu, në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së DHSGJK-së, Dhoma vendosi që gjuha e punës në këtë proces të ishte anglishtja, me përkthim zyrtar të ofruar nga Zyra Administrative në dy gjuhët e tjera zyrtare të DHS-së, përkatësisht në shqipe dhe në serbishte.

C. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE

6. Dhoma do të bëjë shqyrtimin e Kërkesës Referuese, bazuar në vetë Kërkesën Referuese dhe dokumentet e cituara në të. Ky vendim u referohet atyre fakteve të çështjes dhe parashtrimeve të Parashtruesit që janë relevante për vlerësimin e Kërkesës Referuese nga Dhoma.

II. FAKTET

[3] KSC-CC-2024-28, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 14 nëntor 2023. Lidhur me vendin e zhvillimit të procedurave *shih* KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Vendit të Zhvillimit të Procedurës në lidhje me Referimet e Parashtruara në përputhje me Nenin 49 të Ligjit, publike, 18 janar 2019; F00002, Vendim për Vendin e Zhvillimit të Procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

[4] Shih KSC-CC-2022-19, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, publik, 15 dhjetor 2022 ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar*"), para. 3 *in initio*; KSC-CC-2022-18, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publik, 22 gusht 2022, para. 3 *in fine*. Shih gjithashtu KSC-CC-2022-15, F00010, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar, publik, 13 qershor 2022 ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*"), para. 44-45.

A. ARRESTIMI DHE PARAQITJA E PARË E PARASHTRUESIT

7. Më 4 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") kundër Parashtruesit dhe e akuzoi atë për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, konkretisht me një akuzë për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 ("KPK"), dhe me dy akuza për vepra penale kundër rendit publik sipas nenit 401(1) dhe (5) dhe 401(2) dhe (5) të KPK-së.[5] Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu lëshoi një fletarrestim për Parashtruesin dhe një urdhër për transferimin e tij në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë.[6] Në veçanti, krahas konstatimit të dyshimit të bazuar mirë se Parashtruesi kishte kryer ose tentuar të kryente, vetëm ose në bashkëkryerje, veprat penale të lartpërmendura, kishte rënë në marrëveshje për kryerjen e tyre, ose kishte dhënë ndihmë në kryerjen e tyre,[7] Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se kishte arsye të artikulueshme për të besuar se ekzistonte rreziku (ndonëse i moderuar) që parashtruesi të arratisej, të pengonte ecurinë e procesit penal dhe të kryente vepra penale të tjera,[8] çka "bënte të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij" në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit.[9]

8. Më 11 dhjetor 2023, në orën 07:47 të mëngjesit, Parashtruesi u arrestua nga ZPS-

[5] KSC-BC-2023-11, F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, publik, 30 janar 2024 (origjinali u dorëzua më 4 dhjetor 2023) ("Vendimi i Konfirmimit"), para. 155(a); F00013/A01, Aktakuzë e Redaktuar Publike, publike, 12 dhjetor 2023, para. 30. Çështja gjyqësore kundër Parashtruesit (KSC-BC-2023-11) u bashkua me çështjen gjyqësore kundër z. Sabit Januzi dhe z. Ismet Bahtijari (KSC-BC-2023-10), dhe kësaj çështjeje gjyqësore të bashkuar iu caktua numri i lëndës së kësaj të fundit (shih KSC-BC-2023-11, F00041/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës, publik, 8 shkurt 2024 (vendimi origjinal u dorëzua po atë ditë), para. 58(a), (f); KSC-BC-2023-10, F00161/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve Gjyqësore dhe Ndryshimin e Aktakuzës, publik, 8 shkurt 2024 (origjinali u dorëzua po atë ditë), para. 58(a), (f)).
[6] KSC-BC-2023-11, F00006/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Fletarrestim dhe Urdhër Transferimi, publik, 22 dhjetor 2023 (origjinali u dorëzua më 4 dhjetor 2023), me Shtojcat 1-2, publike ("Vendimi për Arrestim dhe Transferim").
[7] Vendimi për Arrestim dhe Transferim, para. 17. Shih gjithashtu Vendimin e Konfirmimit, para. 101, 117, 129, 132, 136, 140, 144, 149.
[8] Vendimi për Arrestim dhe Transferim, para. 18-22.
[9] Vendimi për Arrestim dhe Transferim, para. 23.

ja në Kosovë[10] dhe, më 12 dhjetor 2023, ai u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë.[11] Pas arrestimit, Parashtruesit iu dhanë kopje të legalizuara (në anglishte dhe shqipe) të fletarrestimit dhe urdhrit për transferim, dhe ai u informua për arsyet e arrestimit dhe të drejtat e tij në lidhje me këtë.[12] Fletarrestimi që iu dorëzua Parashtruesit përmbante, ndër të tjera, një përmbledhje të: (i) konstatimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë se Parashtruesi kishte kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, sikurse përshkruhej në Aktakuzën e Konfirmuar,[13] dhe (ii) arsyetimit të dhënë prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake në Vendimin për Arrestim dhe Transferim të Parashtruesit në lidhje me domosdoshmërinë e arrestimit të tij.[14] Në fletarrestim gjithashtu saktësohej se, pas arrestimit dhe transferimit të tij në paraburgim të DHS-së, Parashtruesi do të sillej pa vonesë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit[15] dhe se, në bazë të nenit 41(2) dhe (5) të Ligjit, ai do të kishte gjithashtu të drejtën të paraqiste ankesë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij, të urdhrit për transferim dhe për kushtet e paraburgimit, si dhe të drejtën për të paraqitur apel në Dhomën e Gjykatës së Apelit.[16]

9. Më 12 dhjetor 2023, në përputhje me nenin 39(4) të Ligjit dhe rregullat 87(6) dhe 91(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi datën 13 dhjetor

[10] KSC-BC-2023-11, F00008, Njoftim i Arrestimit të Haxhi Shalës sipas Rregullës 55(4), publik, 11 dhjetor 202, para. 4.
[11] KSC-BC-2023-11, F00011, Njoftim i Pranimit të Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, publik, 12 dhjetor 2023.
[12] KSC-BC-2023-11, F00015/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit mbi Arrestimin dhe Transferimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit me Shtojcat rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* 1-3 (F00015), publik, 3 korrik 2024 (origjinali u dorëzua më 13 dhjetor 2023), para. 11-13.
[13] KSC-BC-2023-11, F00006/RED/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Haxhi Shalën, publik, 28 shkurt 2024 (origjinali u dorëzua më 4 dhjetor 2023) ("Fletarrestimi"), para. 1-3. Shih gjithashtu Vendimin e Konfirmimit, para. 71-101, 103-117, 119-129, 132, 136, 140, 144, 149.
[14] Fletarrestimi, para. 4. Shih gjithashtu Vendimin për Arrestim dhe Transferim, para. 18-23.
[15] Fletarrestimi, para. 9.
[16] Fletarrestimi, para. 10.

2023 si datë të mbajtjes së seancës së paraqitjes së parë të Parashtruesit, që do të ishte publike dhe do të fillonte në orën 14:00.[17]

10. Më 13 dhjetor 2023, Parashtruesi, i ndihmuar nga mbrojtësi kujdestar, u paraqit para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.[18] Në seancë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vijoi me (i) leximin e Aktakuzës së Konfirmuar për Parashtruesin;[19] (ii) marrjen e konfirmimit prej tij se e kuptonte Aktakuzën;[20] (iii) informimin e Parashtruesit për të drejtat e tij para Dhomave të Specializuara dhe shprehu bindjen se të drejtat e Parashtruesit, dhe në veçanti e drejta për mbrojtës, ishin respektuar;[21] (iv) udhëzimin e Parashtruesit në lidhje me vetëdeklarimin si fajtor apo i pafajshëm;[22] dhe (v) caktimin e datave të tjera, sipas nevojës, në ushtrim të funksionit të tij si Gjykatës i Procedurës Paraprake.[23]

11. Para përfundimit të seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pyeti Parashtruesin nëse kishte ndonjë çështje që ai dëshironte të ngrinte "lidhur me arrestimin [e tij], transferimin në Hagë, apo kushtet e paraburgimit".[24] Parashtruesi u përgjigj "jo, nuk kemi" dhe se "gjithçka [ishte] në rregull".[25] Së fundi, pas deklarimit se Parashtruesi do të "mbahej në paraburgim", Gjykatësi i Procedurës Paraprake e informoi atë se "k[ishte] të drejtën që ta kundërshton[te] mbajtjen në paraburgim [të tij] në pajtim me rregullën 57 [të Rregullores]", dhe se kjo çështje "do të trajtohe[j] me anë të vendimeve me shkrim".[26]

B. RISHIKIMI I PARABURGIMIT

[17] KSC-BC-2023-11, F00014, Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Haxhi Shalës dhe Çështjet lidhur me Të, publik, 12 dhjetor 2023, para. 6-8, 14, 22(a).
[18] KSC-BC-2023-11, Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, publik, 13 dhjetor 2023 ("Transkripti i seancës së paraqitjes së parë"), f. 2, rreshtat 21-25.
[19] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 5, rreshti 25 deri në f. 7, rreshti 9.
[20] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 7, rreshtat 15-18.
[21] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 7, rreshti 19 deri në f. 10, rreshti 25.
[22] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 11, rreshti 1 deri në f. 12, rreshti 7.
[23] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 12, rreshti 23 deri në f. 14, rreshti 13.
[24] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 14, rreshti 23 deri në f. 15, rreshti 1.
[25] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 15, rreshtat 2-3.
[26] Transkripti i seancës së paraqitjes së parë, f. 15, rreshtat 5-7.

12. Më 25 janar 2024, duke marrë parasysh se, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, rishikimi i parë i paraburgimit të Parashtruesit duhej të kryhej më 9 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të dorëzonte parashtrime në lidhje me paraburgimin deri më 31 janar 2024, si dhe Parashtruesin që, nëse dëshironte, të dorëzonte përgjigjen e tij ndaj parashtrimeve të ZPS-së deri më 5 shkurt 2024.[27]

13. Më 4 shkurt 2024, Parashtruesi dorëzoi përgjigjen e tij ndaj parashtrimeve të ZPS-së në lidhje me rishikimin e paraburgimit.[28] Parashtruesi, ndër të tjera, pretendoi se ai duhej të lirohej bazuar në paligjshmërinë e vazhdimit të mbajtjes së tij në paraburgim.[29] Konkretisht, ai pretendoi se: (i) ndonëse në fletarrestim dhe në urdhrin për transferim jepej baza ligjore për arrestimin dhe transferimin fillestar të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, ajo nuk mund të shërbente si bazë ligjore e mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit të tij;[30] (ii) nuk i takon personit të paraburgosur të kërkojë lirimin e tij, por është Gjykatësi i Procedurës Paraprake para të cilit sillet personi në fjalë ai që duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e arrestimit, transferimit dhe paraburgimit;[31] dhe (iii) në kundërshtim me kriteret e nenit 5(3) të Konventës, gjatë seancës së paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi themelësinë e paraburgimit të Parashtruesit dhe nuk lëshoi një urdhër për paraburgim përtej periudhës së përcaktuar në fletarrestim dhe në urdhrin për transferim që ishin lëshuar pas kërkesës *ex parte* të ZPS-së.[32] Gjithashtu, Parashtruesi argumentoi se procedura e përcaktuar në Ligj dhe Rregullore është e papajtueshme me nenin 5(3) të Konventës.[33] Parashtruesi argumentoi se, si rezultat, vazhdimi i

[27] KSC-BC-2023-11, F00034, Urdhër për Caktimin e Datës së Dorëzimit të Parashtrimeve në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, publik, 25 janar 2024, para. 3-4.
[28] KSC-BC-2023-11, F00039/RED, Version i Redaktuar Publik i Përgjigjes ndaj Parashtrimeve të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Haxhi Shalës, publike, 7 shkurt 2024 (origjinali u dorëzua më 4 shkurt 2024) ("Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit").
[29] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 1, 28-48, 73(ii), (v).
[30] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 30, 31.
[31] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 32, 34-35.
[32] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 36, 37, 39.
[33] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 33, 41-47.

paraburgimit të tij ishte i paligjshëm dhe se ai duhej të lirohej.[34] Si alternativë, Parashtruesi i kërkoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake t'ia referonte Dhomës çështjen e përputhshmërisë me Kushtetutën dhe Konventën të kornizës ligjore të DHS-së, ku përcaktohet rishikimi fillestar i paraburgimit të një personi.[35]

14. Më 9 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin e parë mbi rishikimin e paraburgimit të Parashtruesit dhe trajtoi paraprakisht, kundërshtimin e Parashtruesit ndaj ligjshmërisë së paraburgimit fillestar të tij.[36] Duke vënë në dukje se (i) vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("GJEDNJ") i cituar prej Parashtruesit në mbështetje të tij, përkatësisht ai në çështjen *Akuilina k. Maltës*, u lëshua në kontekstin e një arrestimi që nuk ishte autorizuar më parë prej gjykatësit; (ii) arrestimi i Parashtruesit, nga ana tjetër, u autorizua nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i cili, në vendimin për arrestim dhe transferim, shqyrtoi të gjitha kriteret themelore për paraburgimin e Parashtruesit në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit; dhe (iii) Parashtruesi e pati mundësinë të kundërshtonte vendimin në fjalë, por nuk e bëri këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kundërshtimin e Parashtruesit.[37] Gjykatësi i Procedurës Paraprake po kështu rrëzoi kërkesën e Parashtruesit për t'ia referuar Dhomës çështjen e përputhshmërisë kushtetuese, duke vënë në dukje se Dhoma tashmë është shprehur në lidhje me përputhshmërinë e dispozitave përkatëse të DHS-së me Kushtetutën.[38] Duke konstatuar më tej se (i) vazhdonin të përmbusheshin kriteret e nenit 41(6) të Ligjit;[39] (ii) kushtet për lirim të propozuara prej Parashtruesit ishin të pamjaftueshme për të zvogëluar rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit penal apo të kryerjes së krimeve të tjera;[40] dhe se (iii) paraburgimi i

[34] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 31, 37-40, 48.
[35] Parashtrimet në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit, para. 49, 73(iii).
[36] KSC-BC-2023-10, F00165/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës, publik, 12 shkurt 2024 (origjinali u dorëzua më 9 shkurt 2024) ("Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit"), para. 12-15.
[37] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 13, 15.
[38] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 14-15.
[39] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 21-23, 30-35, 38-42, 45-47.
[40] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 51-56.

Parashtruesit, në kohën në fjalë, nuk ishte bërë i paarsyeshëm sipas rregullës 56(2) të Rregullores,[41] Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Parashtruesit.[42]

C. APELI I NDËRMJETËM

15. Më 19 shkurt 2024, Parashtruesi dorëzoi një apel të ndërmjetëm kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi rishikimin e paraburgimit.[43] Parashtruesi argumentoi, ndër të tjera, se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që hodhi poshtë kundërshtimin e tij në lidhje me ligjshmërinë e paraburgimit fillestar të tij dhe kërkesës përkatëse për lirim.[44] Duke kujtuar argumentet e veta para Gjykatësit të Procedurës Paraprake,[45] Parashtruesi gjithashtu pretendoi se, meqenëse sipas nenit 5(3) të Konventës, kontrolli gjyqësor i paraburgimit duhet të jetë automatik dhe jo të varet nga kërkesa e personit të paraburgosur, lejimi i tij për të dorëzuar një kërkesë me shkrim pas paraqitjes së parë nuk kishte qenë i mjaftueshëm, pasi kjo çështje duhej të ishte trajtuar në atë seancë.[46] Në mbështetje, ai përmendi jurisprudencën e GJEDNJ-së të përshkruar, ndër të tjera, në çështjet *De Jong, Baljet dhe Van den Brink k. Holandës* dhe *Niedbala k. Polonisë*.[47] Duke u mbështetur gjithashtu në aktgjykimin e GJEDNJ-së në çështjen *Harkmani k. Estonisë*, Parashtruesi ritheksoi se, në kundërshtim me

[41] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 58-60.
[42] Vendimi mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 61(a).
[43] KSC-BC-2023-10, IA002/F00001/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Haxhi Shalës me Shtojcën 1, publik, 22 prill 2024 (origjinali u dorëzua më 19 shkurt 2024) ("Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit").
[44] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 19-21, 25, 30. Shih gjithashtu KSC-BC-2023-10, IA002/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Kundërpërgjigjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, publike, 22 prill 2024 (origjinali u dorëzua më 5 mars 2024) ("Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm"), para. 7-12.
[45] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 13. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm, para. 7-9; më lart, para. 13.
[46] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 16-17. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm, para. 7.
[47] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 16, që i referohet CtHR, *De Jong, Baljet and Van den Brink v. the Netherlands*, nr. 8805/79, 8806/79, 9242/81, 22 maj 1984, para. 51; *Niedbała v. Poland*, no. 2791/95, para. 50.

konstatimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, kriteret e nenit 5(3) të Konventës nuk mund të përmbushen vetëm me përfshirjen e mëhershme të gjykatës në arrestimin e personit të paraburgosur; përkundrazi, gjykatësi duhet ta dëgjojë personin në fjalë, të shqyrtojë rrethanat pro ose kundër paraburgimit të tij, dhe të vendosë, duke iu referuar kritereve ligjore, nëse ekzistojnë arsye që përligjin paraburgimin dhe të urdhërojë lirimin e tij në qoftë se arsye të tilla nuk ekzistojnë.[48] Në këtë aspekt, ai gjithashtu argumentoi se vendimi fillestar për arrestim dhe transferim nuk ofronte garanci të mjaftueshme sipas nenit 5(3) të Konventës, pasi ai u lëshua në bazë të kërkesës *ex parte* të ZPS-së, pa dëgjuar Parashtruesin.[49] Së fundi, duke rikujtuar se kur shqyrtoi përputhshmërinë e Rregullores me Kushtetutën, Dhoma pranoi se nuk ishte në gjendje të përcaktonte në mënyrë përfundimtare dhe në çfarë mase Rregullorja përputhet me Kushtetutën, Parashtruesi pretendoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi që nuk ia referoi Dhomës çështjen e përputhshmërisë së kornizës ligjore të DHS-së me Kushtetutën.[50]

16. Më 12 prill 2024, Paneli i Apelit lëshoi vendim mbi apelin e Parashtruesit.[51] Paraprakisht, Paneli vuri në dukje se, ndonëse Parashtruesi kundërshtoi ligjshmërinë e paraburgimit fillestar të tij, apeli i tij u drejtua kundër vendimit mbi rishikimin e paraburgimit, ku në thelb trajtohej vazhdimi i paraburgimit të Parashtruesit.[52] Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se Parashtruesi kishte pasur mundësinë ta ngrinte këtë pikë në një kohë më të përshtatshme duke kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit fillestar të tij sipas nenit 41(2) të Ligjit dhe rregullës 57 të Rregullores, ose duke parashtruar apel kundër vendimit për arrestim dhe transferim

[48] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 18, që i referohet ECtHR, *Harkmann v. Estonia*, no . 2192/03, 11 korrik 2006, para. 36-38. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm, para. 10.
[49] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 19-21.
[50] Apeli i Ndërmjetëm kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, para. 14, 22-24. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Apelin e Ndërmjetëm, para. 13.
[51] KSC-BC-2023-10, IA002/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Haxhi Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, publik, 12 prill 2024 (origjinali u dorëzua po atë ditë) ("Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm").
[52] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 20.

brenda dhjetë (10) ditësh, duke filluar nga dita e parë e punës pas njoftimit të Parashtruesit për vendimin, në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 58 të Rregullores.[53] Ndonëse Parashtruesi e kishte kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit fillestar të tij për herë të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake në parashtrimet e tij të 4 shkurtit 2024 në lidhje me rishikimin e paraburgimit, Paneli i Apelit konstatoi se, meqenëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kishte trajtuar argumentet e Parashtruesit në lidhje me këtë aspekt, kundërshtimi ishte paraqitur si duhet edhe para tij.[54]

17. Fillimisht, Paneli i Apelit vuri në dukje se qëllimi kryesor i nenit 5(3) të Konventës është që të mbrojë individët nga arbitrariteti "duke garantuar që akti i heqjes së lirisë të jetë objekt i shqyrtimit të pavarur gjyqësor".[55] Paneli gjithashtu vuri në dukje se (i) korniza ligjore e DHS-së ofron garanci të forta ndaj arbitraritetit dhe zgjatjes së panevojshme të paraburgimit përmes parimit të kontrollit gjyqësor të paraburgimit, të sanksionuar në nenin 29(2) të Kushtetutës dhe nenin 41(3) të Ligjit, dhe (ii) neni 41(5) i Ligjit pasqyron nenin 5(3) të Konventës.[56] Në këtë aspekt, Paneli i Apelit konstatoi "se Kushtetuta, Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë se akti i heqjes së lirisë duhet të shqyrtohet nga një autoritet gjyqësor i pavarur", ose para, ose pa vonesë pas arrestimit të të dyshuarit apo të akuzuarit, varësisht nëse arrestimi bazohet në një fletarrestim të lëshuar prej, përkatësisht, Dhomave të Specializuara apo Prokurorit të Specializuar.[57]

53 Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 21. Duke rikujtuar se urdhri për arrestim dhe transferim Parashtruesit i ishte dhënë pas arrestimit, por vendimi për arrestim dhe transferim Parashtruesit iu dha vetëm më 22 dhjetor 2023, kur ishte riklasifikuar si konfidencial, Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se, sipas tij, një të akuzuari para Dhomave të Specializuara duhet t'i jepet sa më shpejt që të jetë e mundur vendimi me të cilin është miratuar kërkesa e ZPS-së për lëshimin e urdhrit për arrestim dhe transferim, mundësisht përpara seancës së paraqitjes së parë të tij (shih Vendimin mbi Apelin e Ndërmjetëm, poshtëshënimin 54).
54 Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 22.
55 Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 24-25.
56 Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 26.
57 Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 26.

18. Duke vënë në dukje se (i) Parashtruesi u arrestua në bazë të një urdhri gjyqësor të lëshuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake, të bashkëlidhur vendimit për arrestim dhe transferim, dhe (ii) ky urdhër gjyqësor përbënte bazën ligjore për paraburgimin e Parashtruesit deri në lëshimin e vendimit të parë mbi rishikimin e paraburgimit të Parashtruesit, Paneli i Apelit konstatoi se, në rastin e Parashtruesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ushtroi kontroll gjyqësor para arrestimit të tij, në përputhje me kornizën ligjore të DHS-së.[58] Paneli i Apelit gjithashtu vuri në dukje se një javë para arrestimit të Parashtruesit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi të gjitha kriteret thelbësore për arrestim sipas nenit 41(6) të Ligjit, të cilat janë të njëjta me ato për paraburgimin dhe pasqyrojnë kriteret e nenit 5(1)(c) të Konventës.[59] Gjithashtu, Paneli i Apelit theksoi se në kornizën ligjore të DHS-së nuk parashikohet posaçërisht lëshimi i një vendimi të veçantë për paraburgim në rast të lëshimit të një fletarrestimi nga një gjykatës, dhe e konstatoi të rëndësishme që neni 41(10) i Ligjit dhe rregulla 57(2) e Rregullores i referohen detyrimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të rishikuar çdo dy muaj vendimin për paraburgim, e jo për të vendosur mbi paraburgimin.[60] Rrjedhimisht, Paneli i Apelit gjykoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake zbatoi si duhet kornizën ligjore të DHS-së.[61]

19. Duke pasur parasysh pretendimin e Parashtruesit se korniza ligjore e DHS-së nuk është në përputhje me nenin 5(3) të Konventës, Paneli i Apelit gjithashtu shqyrtoi nëse kontrolli i ushtruar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi paraburgimin e Parashtruesit, ishte i mjaftueshëm sipas kësaj dispozite për të përligjur vazhdimin e paraburgimit të tij pas arrestimit.[62] Ndonëse u pajtua me Gjykatësin e Procedurës Paraprake se çështja e GJEDNJ-së *Akuilina k. Maltës* lidhej me një gjendje faktike të ndryshme, konkretisht me një arrestim të kryer nga policia, Paneli i Apelit mbajti parasysh gjithashtu se, në çështjet gjyqësore që përfshinin arrestime të autorizuara nga

[58] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 27.
[59] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 28.
[60] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 29.
[61] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 30
[62] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 31.

gjykata, ndër to dhe çështja *Harkmani k. Estonisë*, GJEDNJ-ja kishte konstatuar se në nenin 5(3) të Konventës nuk parashikohet asnjë përjashtim nga detyrimi që personi të sillet pa vonesë para një gjykatësi pas arrestimit dhe paraburgimit të tij, madje as në lidhje me arsyet e përfshirjes së mëparshme të gjykatës.[63] Megjithatë, Paneli i Apelit theksoi se GJEDNJ-ja nuk konstatoi se një urdhër gjyqësor i lëshuar para arrestimit në mungesë të personit të paraburgosur, nuk mund të përbënte bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, por konstatoi shkelje të nenit 5(3) të KEDNJ-së për arsye se personi i paraburgosur nuk ishte sjellë pa vonesë para gjykatësit.[64] Në lidhje me këtë Paneli i Apelit rikujtoi se "GJEDNJ-ja e konsideron thelbësore që personi të sillet *pa vonesë* dhe *automatikisht* para një gjykatësi, që ai ose ajo të dëgjohet personalisht për arsyet e mundshme kundër mbajtjes në paraburgim, dhe që gjykatësi të ketë *kompetencë për ta liruar* në qoftë se paraburgimi nuk përfshihet në përjashtimin e lejuar të përcaktuar në nenin 5(1)(c) [të Konventës], ose është i paligjshëm".[65]

20. Paneli i Apelit gjithashtu theksoi se: (i) Parashtruesi u soll pa vonesë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, konkretisht brenda dy (2) ditësh e gjashtë (6) orësh nga arrestimi i tij; (ii) gjatë seancës së paraqitjes së parë, ai pati mundësinë të fliste me gjykatësin, të raportonte çdo keqtrajtim dhe të ngrinte çdo aspekt që kishte të bënte me arrestimin, transferimin dhe paraburgimin e tij, përfshirë në lidhje me ligjshmërinë dhe themelësinë e paraburgimit të tij; dhe (iii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte kompetencë për ta liruar Parashtruesin, me nismën e vet, në qoftë se paraburgimi ishte i paligjshëm.[66] Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte ushtruar kontroll të mjaftueshëm mbi paraburgimin e Parashtruesit si para ashtu dhe pas arrestimit të Parashtruesit, dhe, për rrjedhojë, kishte përmbushur kriteret e nenit 5(3) të Konventës.[67] Në këtë aspekt, Paneli i Apelit

[63] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 32-33.
[64] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 34.
[65] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 34.
[66] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 35.
[67] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 36. Paneli i Apelit gjithashtu evidentoi garanci mbrojtëse të tjera ndaj arbitraritetit të përcaktuara në Ligj dhe Rregullore (shih Vendimin mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 37).

gjithashtu vërejti se, ndonëse do të kishte qenë më mirë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake t'i ishte referuar shprehimisht bazës ligjore për paraburgimin të arsyetuar në fletarrestim dhe në vendimin për arrestim dhe transferim dhe, meqenëse këto procedura ishin *ex parte*, të ftonte Parashtruesin të paraqiste argumentet e veta në lidhje me paraburgimin gjatë seancës së paraqitjes së parë, kjo nuk ishte e domosdoshme sipas kritereve të Konventës.[68] Për këto arsye, Paneli i Apelit konstatoi se Parashtruesi nuk provoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte gabuar me hedhjen poshtë të kundërshtimit të tij ndaj ligjshmërisë së paraburgimit fillestar të Parashtruesit, dhe e rrëzoi kërkesën e Parashtruesit për lirim të menjëhershëm.[69]

21. Së fundi, duke pasur parasysh konstatimet e veta, Paneli i Apelit arriti në përfundimin se nuk ekzistonte paqartësi në lidhje me përputhshmërinë e kornizës ligjore të DHS-së, që përcakton rishikimin fillestar të paraburgimit të një personi, me Kushtetutën.[70]

D. KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

22. Më 12 korrik 2024, Parashtruesi i dorëzoi një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Panelit të Gjykatës Supreme.[71] Parashtruesi argumentoi se Paneli i Apelit kishte bërë gabim që kishte konstatuar se (i) kontrolli gjyqësor i paraburgimit mund të ndodhë para paraburgimit të personit, dhe (ii) kompetenca e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për ta liruar personin me nismën e vet, ofronte një garanci të mjaftueshme.[72] Kryesisht, Parashtruesi argumentoi se neni 5(3) i Konventës, i interpretuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, kërkon që ligjshmëria dhe themelësia e paraburgimit të

[68] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 36
[69] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 38.
[70] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 41.
[71] KSC-BC-2023-10, PL001/F00001, Kërkesë për Mbrojtjen e Ligjshmërisë kundër Vendimit mbi Apelin e Haxhi Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, publike, 12 korrik 2024 ("Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë").
[72] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 18-29.

një personi të shqyrtohen automatikisht, pasi personi të jetë paraburgosur.[73] Parashtruesi argumentoi se, pretendimi se një detyrim i tillë mund të përmbushet para paraburgimit të personit, do të binte ndesh me qëllimin e nenit 5(3) të Konventës.[74] Sipas tij, kompetenca *proprio motu* e gjykatësit për ta liruar personin, nuk e liron atë nga detyrimi për të kryer një vlerësim të ligjshmërisë pas paraburgimit.[75] Po kështu, Parashtruesi argumentoi se neni 41(3) i Ligjit nuk është në përputhje me nenin 5(3) të Konventës, pasi në të bëhet dallim midis atyre që janë objekt i një urdhri paraprak paraburgimi të lëshuar prej Dhomave të Specializuara, dhe atyre që nuk janë objekt i një urdhri të tillë.[76] Në lidhje me këtë, Parashtruesi ritheksoi se Dhoma nuk përcaktoi në mënyrë përfundimtare përputhshmërinë e kornizës ligjore të DHS-së, ku përcaktohet rishikimi fillestar i paraburgimit të personit, me Kushtetutën.[77] Së fundi, Parashtruesi pretendoi se ai ishte mbajtur në mënyrë të paligjshme në paraburgim që nga 13 dhjetori 2023, dhe argumentoi se duhej të ishte liruar dhe të zhdëmtohej, përkatësisht, në bazë të nenit 5(4) të Konventës dhe rregullës 51 të Rregullores.[78]

23. Më 9 shtator 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi vendimin në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.[79] Fillimisht, Paneli i Gjykatës Supreme rikujtoi, ndër të tjera, qëllimin e nenit 5(3) të Konventës, si dhe interpretimin e tij prej GJEDNJ-së si dispozitë që përfshin edhe kriterin procedural edhe atë material.[80] Paneli i Gjykatës Supreme gjithashtu sqaroi se pika që i ishte parashtruar nuk kishte të bënte

[73] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 18, 20-26. Shih gjithashtu KSC-BC-2023-10, PL001/F00005, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes së Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publike, 19 gusht 2024 ("Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë"), para. 10, 13, 20.
[74] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 23. Shih Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 10.
[75] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 28-29. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 17-18.
[76] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 31-33. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 21.
[77] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 34.
[78] Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 35-39. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, para. 9, 11.
[79] KSC-BC-2023-10, PL001/F00006, Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publik, 9 shtator 2024 ("Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë").
[80] Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 35-38.

me shpejtësinë me të cilën Parashtruesi u soll para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pas arrestimit të tij, apo me kompetencën e këtij të fundit për ta liruar atë, por me nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ishte përmbajtur nenit 41(5) të Ligjit dhe nenit 5(3) të Konventës në lidhje me rishikimin automatik të paraburgimit të Parashtruesit.[81] Paneli i Gjykatës Supreme vërejti se: (i) arrestimi dhe paraburgimi i Parashtruesit u urdhëruan nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i cili shqyrtoi personalisht dhe në mënyrë të plotë të gjitha kriteret për paraburgim të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit dhe nenin 5(1)(c) të Konventës; (ii) pas arrestimit të tij, Parashtruesit iu dhanë kopje të legalizuara (në anglishte dhe shqipe) të fletarrestimit dhe urdhrit për transferim, dhe ai u informua për arsyet e arrestimit si dhe për të drejtat e tij; dhe (iii) në seancën e paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i dha Parashtruesit mundësinë të shprehte të gjitha shqetësimet e tij në lidhje me arrestimin, transferimin dhe paraburgimin, dhe pasi dëgjoi përgjigjen e tij, vendosi që Parashtruesi të mbetej në paraburgim.[82] Rrjedhimisht, Paneli i Gjykatës Supreme gjykoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ndërmori hapat e kërkuar sipas nenit 41(6) të Ligjit dhe nenit 5(1)(c) të Konventës.[83] Për rrjedhojë, Paneli i Gjykatës Supreme nuk konstatoi shkelje thelbësore të procedurave nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake apo e Panelit të Apelit dhe, mbi këtë bazë, gjithashtu rrëzoi si të tejkaluar argumentet e Parashtruesit në lidhje me përputhshmërinë e nenit 41(3) të Ligjit me nenin 5(3) të Konventës.[84]

E. KËRKESA PËR RISHIKIM

24. Më 18 shtator 2024, Parashtruesi dorëzoi kërkesën për rishikim të vendimit të Panelit të Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën e Parashtruesit për mbrojtje të

[81] Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 39.
[82] Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 40-42.
[83] Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 43.
[84] Vendimi mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë, para. 43-44.

ligjshmërisë.[85] Në veçanti, Parashtruesi argumentoi se, meqenëse (i) Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mori vendim në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të Parashtruesit në seancën e paraqitjes së parë, dhe (ii) as Gjykatësi i Procedurës Paraprake e as Paneli i Apelit nuk konstatoi se gjatë seancës së paraqitjes së parë ishte marrë vendim për këtë aspekt, vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme ishte bazuar në një gabim të qartë të faktit material.[86] Ai pretendoi se rishikimi ishte i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë dhe për të korrigjuar një gabim themelor faktik në të cilin u mbështet vendimi i Panelit të Gjykatës Supreme në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.[87]

25. Më 16 tetor 2024, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi vendimin e vet në lidhje me kërkesën për rishikim.[88] Duke vënë në dukje se kërkesat për rishikim janë mjet juridik i posaçëm, Paneli i Gjykatës Supreme konstatoi se Parashtruesi nuk provoi se ishte bërë gabim në arsyetimin e vendimit në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ose se rishikimi i vendimit ishte i domosdoshëm për të shmangur padrejtësinë dhe, rrjedhimisht e rrëzoi kërkesën.[89] Përkundrazi, Paneli i Gjykatës Supreme ishte i mendimit se Parashtruesi thjesht nuk u pajtua me arsyetimin gjyqësor dhe me rezultatin e vendimit të kundërshtuar.[90] Në veçanti, Paneli i Gjykatës Supreme vuri në dukje se "është e vetëkuptueshme që një gjykatë e shkallës më të lartë të shqyrtojë faktet dhe aspektet ligjore në mënyrë të pavarur, dhe mund të arrijë në një përfundim apo cilësim të ndryshëm të fakteve apo aspekteve ligjore nga gjykatat e

[85] KSC-BC-2023-10, PL001/F00009, Kërkesë e Riparashtruar e Haxhi Shalës për Rishikim të Vendimit të Dhomës së Gjykatës Supreme në lidhje me Kërkesën e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publike, 18 shtator 2024 ("Kërkesa për Rishikim").
[86] Kërkesa për Rishikim, para. 3-5, 7-18. Shih gjithashtu KSC-BC-2023-10, PL001/F00012, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj Përgjigjes së Prokurorisë në lidhje me Kërkesën e Haxhi Shalës për Rishikim të Vendimit të Dhomës së Gjykatës Supreme në lidhje me Kërkesën e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, publike, 5 tetor 2024 ("Kundërpërgjigjja ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Kërkesën për Rishikim"), para. 3-5, 7-8, 10-11.
[87] Kërkesa për Rishikim, para. 5, 18-19. Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Kërkesën për Rishikim, para. 5, 12-13.
[88] KSC-BC-2023-10, PL001/F00013, Vendim mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Rishikim të Vendimit në lidhje me Mbrojtjen e Ligjshmërisë, publik, 16 tetor 2024 ("Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim").
[89] Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim, para. 18-19, 24-25.
[90] Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim, para. 19.

shkallës më të ulët".[91] Sipas Panelit të Gjykatës Supreme, deklaratat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me bazën ligjore për paraburgimin e Parashtruesit dhe konstatimet e mëpasshme të Panelit të Apelit në lidhje me këtë aspekt, nuk mund të përbënin arsye për rishikim.[92] Duke rikujtuar konstatimet e bëra në vendimin në lidhje me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, dhe duke vënë gjithashtu në dukje se të drejtat e parashtruesit ishin mbrojtur mjaftueshëm nga dhomat penale në përputhje me Ligjin dhe nenin 5(3) të Konventës, Paneli i Gjykatës Supreme po kështu konstatoi se Parashtruesi nuk kishte provuar se ky vendim do të shkaktonte padrejtësi.[93]

III. SHKELJA E PRETENDUAR

26. Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi u ankua para Dhomës së, gjatë seancës së paraqitjes së parë të tij, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte marrë vendim në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të Parashtruesit pas arrestimit në Kosovë dhe transferimit të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë.[94] Si rezultat, Parashtruesi pretendoi se ishte viktimë e shkeljes së nenit 5(3) të Konventës.[95]

IV. JURIDIKSIONI

27. Dhoma vëren se Parashtruesi e paraqiti Kërkesën Referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës dhe parashtroi ankesa në lidhje me arrestimin dhe paraburgimin e tij, të urdhëruara prej Dhomave të Specializuara. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese ka të bëjë me DHS-në dhe ZPS-në, sikurse përcaktohet në nenin 162(3) të Kushtetutës dhe në nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Për këtë arsye, Dhoma ka juridiksion për të marrë vendim mbi Kërkesën Referuese.

V. KUADRI I SHQYRTIMIT

[91] Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim, para. 22.
[92] Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim, para. 21-22.
[93] Vendimi mbi Kërkesën për Rishikim, para. 23.
[94] Kërkesa Referuese, para. 18.
[95] Kërkesa Referuese, para. 19, 36(i).

28. Fillimisht, Dhoma rikujton rolin e vet për mbikëqyrjen e punës së DHS-së dhe ZPS-së në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.[96] Në bazë të nenit 49(1) të Ligjit, Dhoma është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e DHS-së dhe ZPS-së.

29. Sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, Dhoma thekson se, në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, garancitë e parashikuara në Konventë gjejnë zbatim në nivel kushtetues.[97] Faktikisht, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka ritheksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura në nenin 22 të Kushtetutës "kanë statusin e normave të rendit kushtetues dhe janë pjesë integrale e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës".[98] Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se, meqenëse ankesa e Parashtruesit lidhet me nenin 5(3) të Konventës, ajo shqyrtohet në bazë të kësaj dispozite.[99]

30. Në lidhje me vlerësimin e Kërkesës Referuese, Dhoma vë në dukje se, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë "interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]". Gjithashtu, Gjykata Kushtetues e Kosovës vazhdimisht ka pranuar dhe konfirmuar zbatimin e nenit 53 të Kushtetutës në vlerësimet prej saj të Kërkesave

[96] Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Nasim Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 31 maj 2024 ("*Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*"), para. 65. Shih gjithashtu KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 Dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019 ("*Vendimi mbi Referimin e M. Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë*"), para. 24 .

[97] Shih, për shembull, KSC-CC-2022-13, F00010; KSC-CC-2022-14, F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, publik, 13 qershor 2022 ("*Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale")*, para. 34, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.

[98] Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH. nr. 21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111

[99] Shih, për ngjashmëri, *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*, para. 66; *Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 34-35.

Referuese drejtuar Gjykatës Kushtetuese.[100] Ajo gjithashtu është shprehur se "Gjykata Kushtetuese *është e obliguar* që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në pajtim me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]".[101] Mbi këtë bazë, dhe duke pasur parasysh nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës, në shqyrtimin e Kërkesës Referuese të Parashtruesit, kjo Dhomë i kushton vëmendje të veçantë jurisprudencës së GJEDNJ-së.[102]

VI. PRANUESHMËRIA

31. Fillimisht, Dhoma duhet të përcaktojë nëse ankesa e Parashtruesit është e pranueshme.[103] Kjo rrjedh nga neni 113(1) i Kushtetutës, sipas të cilit Dhoma vendos vetëm për rastet "e ngritura para [saj] në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".[104] Gjithashtu, rregulla 15(1) e Rregullores së DHSGJK-së përcakton se Dhoma vendos mbi "pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e një referimi të bërë në bazë të nenit 49 të

[100] Shih, për shembull, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, Kërkesë për Vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 37; Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit Pn II nr. 1/17 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 30 Janarit 2017 në lidhje me Vendimin Pml nr. 300/16 të Gjykatës Supreme të 12 dhjetorit 2016, KI 62/17, Aktgjykim, 29 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 43; Kërkesë për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017, KI 34/18, Aktvendim për papranueshmëri, 23 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 41.

[101] Kosovë, Gjykata Kushtetuese, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës PML. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015, KI 43/16, Aktvendim për Papranueshmëri, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50 (theksimi i shtuar)

[102] Shih, për ngjashmëri, *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*, para. 67; *Vendimi mbi Referimin e M. Hasanit në lidhje me Urdhrin e ZPS-së*, para. 26.

[103] Shih, për shembull, KSC-CC-2023-21, F00006, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, publik, 29 gusht 2023 ("Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme"), para. 19; *Vendim mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 36.

[104] *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*, para. 70; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 19; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar*, para. 14. Shih gjithashtu, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AE. nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike Vendimit I.EK. nr. 330/2019 të 1 gushtit 2019, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68-69; Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018, KI 12/19, Aktvendim për papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30-31 .

Ligjit". Këto dispozita parashikojnë përgjegjësinë e Dhomës për të vlerësuar së pari, *ex officio*, nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme apo jo.[105]

32. Lidhur me aspektin e pranueshmërisë, Dhoma pajtohet me Panelin e Apelit se Parashtruesi duhej të kishte shfrytëzuar mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit fillestar të tij në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 57 të Rregullores, ose duke parashtruar apel kundër vendimit për arrestim dhe transferim brenda dhjetë (10) ditësh, duke filluar nga dita e parë e punës pas njoftimit të Parashtruesit për vendimin, në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 58 të Rregullores.[106] Në të njëjtën kohë, Dhoma vëren se autoritetet kompetente, konkretisht Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Paneli i Apelit dhe Paneli i Gjykatës Supreme sidoqoftë shqyrtuan pretendimin e Parashtruesit në lidhje me themelësinë.[107] Rrjedhimisht, Dhoma është e mendimit se nuk mund të thuhet se Parashtruesi nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të parashikuara në ligj ndaj shkeljes së pretenduar sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së.[108]

33. Dhoma gjithashtu vëren se ankesa nuk është e papranueshme në raport me cilëndo prej arsyeve të tjera, të përcaktuara në rregullën 14 të Rregullores së DHSGJK-së. Rrjedhimisht, ajo duhet të shpallet e pranueshme dhe të shqyrtohet themelësia e saj.

VII. THEMELËSIA

A. ARGUMENTET E PARASHTRUESIT

[105] *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*, para. 70; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 19; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar*, para. 14; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 43.
[106] Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 21. Shih gjithashtu më lart, para. 16.
[107] Shih më lart, para. 14, 16-21, 23.
[108] Shih, për ngjashmëri, ECtHR, *Savickis and Others v. Latvia* [GC], no. 49270/11, 9 June 2022, para. 140. Shih gjithashtu *Aktvendimin mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt*, para. 85, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.

34. Parashtruesi u ankua, në veçanti, se mosshqyrtimi prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake i ligjshmërisë dhe themelësisë së paraburgimit të tij, dhe mosmarrja e një vendimi në lidhje me këtë në seancën e paraqitjes së parë më 13 dhjetor 2023, shkeli të drejtën e tij për liri dhe siguri sipas nenit 5(3) të Konventës.[109] Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Parashtruesi argumentoi se kontrolli gjyqësor i paraburgimit sipas nenit 5(3) të Konventës, është automatik, vepron si garanci mbrojtëse e pavarur për personin e paraburgosur, dhe nuk varet nga kërkesat e personit në fjalë.[110] Ai gjithashtu argumentoi se neni 5(3) i Konventës zbatohet pavarësisht nëse është autorizuar paraprakisht apo jo arrestimi i personit nga gjykatësi, dhe ritheksoi se, duke pasur parasysh konstatimet e GJEDNJ-së në çështjen *Harkmani k. Estonisë*, "kriteret e nenit 5(3) të Konventës nuk mund të përmbushen vetëm me 'përfshirjen e mëhershme të gjykatës'".[111] Në lidhje me këtë, Parashtruesi kritikoi mbështetjen e Panelit të Gjykatës Supreme në hapat e ndërmarrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake para arrestimit të tij, dhe argumentoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte marrë vendim mbi themelësinë e paraburgimit të Parashtruesit në seancën e paraqitjes së parë të tij.[112] Gjithashtu, ai përsëriti argumentin e paraqitur para dhomave penale në lidhje me përputhshmërinë e kornizës ligjore të DHS-së që përcakton rishikimin fillestar të paraburgimit të një personi me Kushtetutën dhe Konventën, dhe pretendoi se neni 41(5)-(6) të Ligjit nuk përfshin kriterin për marrjen e vendimit në lidhje me themelësinë e paraburgimit në paraqitjen e parë, kur personi i paraburgosur sillet para gjykatësit.[113]

B. VLERËSIMI I DHOMËS

[109] Kërkesa Referuese, para. 18, 36(i).
[110] Kërkesa Referuese, para. 20, 22, 35.
[111] Kërkesa Referuese, para. 29, që i referohet ECtHR, *Harkmann v. Estonia* , të cituar më lart, para. 36-38.
[112] Kërkesa Referuese, para. 23-24, 26-28, 30-34.
[113] Kërkesa Referuese, para. 25, 28.

35. Fillimisht, Dhoma rikujton se, sipas nenit 53 të Kushtetutës, gjatë shqyrtimit të themelësisë së ankesës kushtetuese të Parashtruesit, ajo do t'u referohet parimeve të përgjithshme të zhvilluara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.[114]

36. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se në nenin 5(3) të Konventës thuhet si më poshtë:

> "Çdokush që arrestohet ose ndalohet në kushtet e parashikuara në paragrafin 1(c) të këtij neni, duhet të dërgohet menjëherë para një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor."

37. Krahas sa më lart, Dhoma vëren se, siç përcaktohet në jurisprudencën e GJEDNJ-së, neni 5(3) i Konventës u jep personave të arrestuar ose të paraburgosur që dyshohen se kanë kryer vepër penale, një garanci ndaj arbitraritetit apo heqjes së papërligjur të lirisë.[115] Nga pikëpamja strukturore, ky nen trajton dy aspekte të ndara, konkretisht (i) fazat e hershme pas arrestimit, kur personi vendoset nën kontrollin dhe ruajtjen e autoriteteve, dhe (ii) periudhën në pritje të gjykimit para një gjykate penale, gjatë së cilës personi mund të mbahet në paraburgim apo të lirohet pa kushte. Këto dy elemente përfshijnë të drejta të dallueshme dhe, në pamje të parë, ato nuk kanë lidhje logjike apo kohore me njëra-tjetrën.[116] Rrjedhimisht, ajo që në jurisprudencën e GJEDNJ-së përshkruhet si "pjesa hyrëse e [nenit 593) të Konventës]" garanton të drejtën për t'u sjellë pa vonesë para një gjykatësi apo "zyrtari tjetër", ndërsa pjesa e dytë e dispozitës garanton të drejtën për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose

[114] Shih më lart, para. 30; *Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 45, 75.
[115] ECtHR, *Stephens v. Malta (no. 2)*, no. 33740/06, 21 April 2009, para. 52; *Aquilina v. Malta* [GC], no. 25642/94, 29 April 1999, para. 47.
[116] ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, nos 26289/12, 29062/12, 29891/12, 12 May 2015, para. 75; *Stephens v. Malta (no. 2)*, cituar më lart, para. 52.

për t'u liruar në pritje të gjykimit.[117]

38. Në këtë kontekst, Dhoma rikujton se Kërkesa Referuese lidhet me fazat fillestare të paraburgimit të Parashtruesit, rrjedhimisht me elementin e parë të nenit 5(3) të Konventës. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së është përcaktuar se, në fazën fillestare sipas elementit të parë, personi i arrestuar apo i paraburgosur me dyshimin se ka kryer vepër penale, duhet të mbrohet nëpërmjet kontrollit gjyqësor. Ky kontroll synon të ofrojë garanci mbrojtëse të efektshme ndaj rrezikut të keqtrajtimit, i cili në këtë fazë të hershme të paraburgimit është në nivelin më të lartë, dhe ndaj keqpërdorimit të pushtetit nga zyrtarët e rendit dhe të ligjit apo autoritetet e tjera.[118] Dhoma gjithashtu vëren se, sipas jurisprudencës relevante, kontrolli gjyqësor duhet të përmbushë disa kritere, të përcaktuara më poshtë.

39. *Sjellja pa vonese para gjykatësit.* Kontrolli gjyqësor mbi paraqitjen e parë të personit të arrestuar duhet para së gjithash të kryhet pa vonesë, për të mundësuar zbulimin e çdo keqtrajtimi dhe për të mbajtur në nivel minimal çdo ndërhyrje të papërligjur ndaj lirisë së personit.[119] Konkretisht, GJEDNJ-ja ka gjykuar se çdo periudhë që zgjat më shumë se katër (4) ditë, është *prima facie* tepër e gjatë,[120] por edhe periudhat më të shkurtra është konstatuar se shkelin këtë kriter, në qoftë se nuk ka vështirësi të posaçme apo rrethana të jashtëzakonshme që i pengojnë autoritetet ta sjellin më shpejt personin e arrestuar para gjykatësit .[121]

40. *Natyra automatike e rishikimit.* Gjithashtu, kontrolli gjyqësor i paraburgimit duhet të jetë automatik dhe të mos varet nga kërkesa e personit të paraburgosur. Në këtë aspekt, neni 5(3) duhet dalluar nga neni 5(4) i Konventës, në të cilin personit të

[117] ECtHR, *Stephens v. Malta (no. 2)*, cituar më lart, para. 52. Shih gjithashtu ECtHR, *Assenov and Others v. Bulgaria*, no. 24760/94, 28 October 1998, para. 143.
[118] ECtHR, *Vakhitov and Others v. Russia*, nos 18232/11, 42945/11, 31596/14, 31 January 2017, para. 46; *Magee and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 76.
[119] ECtHR, *McKay v. the United Kingdom* [GC], no. 543/03, 3 October 2006, para. 33.
[120] Shih, për shembull, ECtHR, *Brogan and Others v. the United Kingdom*, nos 11209/84, 11234/84, 11266/84, 11386/85, 29 November 1988, para. 62.
[121] Shih, për shembull, ECtHR, *Gutsanovi v. Bulgaria*, no. 34529/10, 15 October 2013, paras 154-159.

paraburgosur i jepet e drejta të bëjë kërkesë për lirim.[122] Natyra automatike e rishikimit është e domosdoshme për të përmbushur qëllimin e nenit 5(3) të Konventës, pasi personi që është objekt i keqtrajtimit, apo kategori të tjera të cenueshme të personave të arrestuar, siç janë personat e brishtë mendërisht apo ata që nuk flasin gjuhën e zyrtarit të gjykatës, mund të jenë të paaftë të paraqesin ankesë për t'i kërkuar gjykatësit të rishikojë paraburgimin e tyre.[123]

41. *Veçoritë dhe kompetencat e zyrtarit të gjykatës.* Kushti i parë lidhur me zyrtarin e gjykatës është që ai ose ajo duhet të ofrojë garancitë e nevojshme të pavarësisë nga ekzekutivi, dhe duhet të ketë kompetencën për të urdhëruar lirimin, pasi të ketë dëgjuar personin dhe të ketë vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe arsyet për të.[124] Lidhur me kuadrin e shqyrtimit, në jurisprudencën e konsoliduar prej kohësh të GJEDNJ-së përcaktohet se, sipas nenit 5(3) të Konventës, ekziston si kriteri procedural ashtu dhe kriteri material. Konkretisht, kriteri i parë e vendos "zyrtarin" para detyrimit për ta dëgjuar vetë personin e sjellë para tij, ndërsa kriteri i dytë e detyron atë të rishikojë rrethanat pro apo kundër mbajtjes në paraburgim, për të vendosur – duke iu referuar kritereve ligjore – nëse ekzistojnë apo jo arsye që përligjin mbajtjen në paraburgim, dhe për të urdhëruar lirimin në qoftë se nuk ekzistojnë arsye të tilla.[125]

42. Në këtë aspekt, Dhoma vëren se GJEDNJ-ja nuk ka përcaktuar përmbajtjen e saktë dhe/ose formën e analizës që kërkohet të kryhet sipas nenit 5(3) të Konventës.[126] Megjithatë, GJEDNJ-ja ka sqaruar se ky rishikim jo domosdoshmërisht duhet të mbulojë, si detyrim automatik, aspekte të tilla si lirimi me kusht,[127] dhe mund të ketë kuadër më të kufizuar në rrethanat e veçanta të një çështjeje gjyqësore se rishikimi

[122] ECtHR, *McKay v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 34; *Aquilina v. Malta* [GC], cituar më lart, para. 49.
[123] ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 79; *McKay v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 34; *Aquilina v. Malta* [GC], cituar më lart, para. 49.
[124] ECtHR, *McKay v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 35. Shih gjithashtu ECtHR, *Assenov and Others v. Bulgaria*, cituar më lart, para. 146.
[125] ECtHR, *Schiesser v. Switzerland*, no. 7710/76, 4 December 1979, para. 31.
[126] ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 98.
[127] ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, paras 84, 101; *McKay v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, paras 36-39.

sipas nenit 5(4) të Konventës.[128] Konkretisht, GJEDNJ-ja është shprehur se gjatë shqyrtimi fillestar automatik të arrestimit dhe paraburgimit duhet të shqyrtohen aspektet e ligjshmërisë dhe nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi i arrestuar ka kryer vepër penale, përkatësisht nëse përfshihet apo jo paraburgimi në përjashtimin e lejuar të përcaktuar në nenin 5(1)(c) të Konventës.[129]

43. GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar se kriteret e nenit 5(3) të Konventës të përcaktuara më lart, zbatohen edhe për situata në të cilat personi arrestohet në bazë të një urdhri për paraburgim të lëshuar nga gjykata në mungesë të tij,[130] dhe ka sqaruar se në formulimin e nenit 5(3) të Konventës nuk parashikohen përjashtime të mundshme, madje as në lidhje me arsyet e përfshirjes së mëhershme të gjykatës.[131] Në lidhje me këtë, Dhoma gjithashtu vëren se, në raste të tilla, GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të nenit 5(3) të Konventës, ndër të tjera, për arsye se: (i) pas arrestimit, personi i ndaluar nuk është sjellë pa vonesë para gjykatësit, i është mohuar mundësia që t'i paraqesë gjykatës arsyet e mundshme personale kundër paraburgimit;[132] (ii) personi është arrestuar dhe më pas është paraburgosur në bazë të urdhrit të gjykatës të lëshuar në mungesë të tij, dhe në legjislacionin vendor nuk ka qenë i parashikuar shqyrtimi fillestar automatik i paraburgimit, duke bërë që mbajtja në paraburgim të varet nga kërkesa e personit të paraburgosur;[133] dhe (iii) pas arrestimit, personi është sjellë pa vonesë dhe automatikisht para gjykatësit, por ky i fundit nuk ka marrë deklaratat e personit dhe nuk ka shqyrtuar rrethanat pro apo kundër paraburgimit, duke u kufizuar vetëm në verifikimin e identitetit të personit të ndaluar dhe në njoftimin e tij

[128] ECtHR, *Stephens v. Malta (no. 2)*, cituar më lart, paras 58.
[129] ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, , cituar më lart, para. 83; *McKay v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 40.
[130] ECtHR, *Vakhitov and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 50, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.
[131] Shih, për shembull, ECtHR, *Harkmann v. Estonia*, cituar më lart, para. 38.
[132] ECtHR, *Vakhitov and Others v. Russia*, cituar më lart, paras 52-54; *Kornev and Karpenko v. Ukraine*, no. 17444/04, 21 October 2010, paras 45-48; *Bergmann v. Estonia,* no. 38241/04, 29 May 2008, paras 42-47; *Harkmann v. Estonia*, cituar më lart, paras 37-40.
[133] ECtHR, *Piotr Nowak v. Poland*, no. 7337/05, 7 December 2010, paras 61-62; *Ladent v. Poland*, no. 11036/03, 18 March 2008, paras 75-76.

për fletarrestimin ndaj tij.[134]

44. Para se të trajtojmë zbatimin e parimeve të mësipërme në këtë çështje, duke pasur parasysh pretendimin e bërë nga Parashtruesi se neni 41(5) i Ligjit nuk përfshin kriterin që vendimi mbi paraburgimin të merret në paraqitjen e parë të personit të arrestuar para gjykatësit,[135] Dhoma e gjykon të nevojshme të bëjë një vërejtje paraprake. Konkretisht, ajo vëren se neni 41(5) i Ligjit pasqyron, *mutatis mutandis*, gjuhën e përdorur në nenin 5(3) të Konventës. Duke rikujtuar se, sipas neneve 22(2) dhe 53 të Kushtetutës, garancitë e parashikuara në Konventë zbatohen drejtpërdrejt në nivel kushtetues, dhe të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë duhet të interpretohen në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ-së,[136] Dhoma gjykon se kriteret e nenit 5(3) të Konventës të përshkruara në paragrafët e mësipërm, zbatohen edhe në kontekstin e DHS-së.

45. Sa i përket çështjes aktuale, Dhoma rikujton, së pari, se Parashtruesi u arrestua nga ZPS-ja në Kosovë më 11 dhjetor 2023 dhe, më 12 dhjetor 2023, u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, në bazë të fletarrestimit dhe urdhrit për transferim të lëshuar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake më 4 dhjetor 2023.[137] Në fletarrestimin që iu dorëzua Parashtruesit saktësohej se ai do të sillej pa vonesë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit.[138] Më 13 dhjetor 2023, Parashtruesi u paraqit para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.[139] Duke vënë në dukje se Parashtruesi u soll para Gjykatësit të Procedurës Paraprake brenda dy (2) ditësh dhe gjashtë (6) orësh nga arrestimi i tij, si dhe duke mbajtur parasysh se për këtë u desh që Parashtruesi të transferohej nga Kosova në Holandë,[140] Dhoma

[134] ECtHR, *Vedat Doğru v. Turkey*, no. 2469/10, 5 April 2016, paras 55-57; *Abdulsitar Akgül v. Turkey*, no. 31595/07, 25 June 2013, paras 20-22; *Salih Salman Kiliç v. Turkey*, no. 22077/10, 5 March 2013, paras 26-29.
[135] Kërkesa Referuese, para. 25. Shih gjithashtu më lart, para. 34.
[136] Shih më lart, para. 29-30.
[137] Shih më lart, para. 7-8.
[138] Shih më lart, para. 8.
[139] Shih më lart, para. 8-10.
[140] Shih më lart, para. 8-10.

konstaton se ai u soll pa vonesë dhe automatikisht para gjykatësit sipas nenit 5(3) të Konventës. Sido që të jetë, Dhoma vëren se Parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë argument për të kundërtën. Po kështu, Dhoma vëren se pavarësia e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 5(3) të Konventës, nuk është në diskutim. Rrjedhimisht, të gjithë pajtohen se Gjykatësi i Procedurës Paraprake ishte i pavarur.[141]

46. Gjithashtu, duke pasur parasysh, ndër të tjera, nenin 41(10) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores, Dhoma është e mendimit se në Ligj apo në Rregullore nuk ka asgjë që të lë të kuptosh se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte kompetencë për të shqyrtuar aspektet që lidhen me ligjshmërinë e paraburgimit dhe nëse ekzistonte apo jo dyshimi i arsyeshëm se Parashtruesi kishte kryer vepër penale (d.m.th. që paraburgimi përfshihej në përjashtimin e lejuar të përcaktuar në nenin 5(1)(c) të Konventës), për të marrë parasysh rrethanat e ndryshme pro apo kundër paraburgimit, dhe për të urdhëruar lirimin në qoftë se nuk ekzistonin arsye të tilla. Në fakt, ndonëse është e vërtetë se, sikurse vuri në dukje Paneli i Apelit, në kornizën ligjore të DHS-së nuk parashikohet shprehimisht lëshimi i vendimit për paraburgim në seancën e paraqitjes së parë,[142] Dhoma mban qëndrimin se formulimi i nenit 41(10 të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, që lidhen me detyrën e Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të rishikuar paraburgimin nga "vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin", nuk përjashton, *a priori*, që një vendim i tillë të merret nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në seancën e paraqitjes së parë.[143]

47. Rrjedhimisht, mbetet për t'u vlerësuar nëse, në seancën e paraqitjes së parë më 13 dhjetor 2023, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi ligjshmërinë dhe themelësinë e paraburgimit të Parashtruesit. Dhoma është e mendimit se, meqenëse fletarrestimi dhe urdhri për transferim i 4 dhjetorit 2023 u lëshuan *ex parte*, pa e dëgjuar Parashtruesin në lidhje me arsyet e mundshme personale kundër paraburgimit të tij, kriteret e nenit 5(3) të Konventës e detyronin Gjykatësin e

[141] Shih, për ngjashmëri, ECtHR, *Magee and Others v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 96.
[142] Shih më lart, para. 18.
[143] Krahaso. Vendimi mbi Apelin e Ndërmjetëm, para. 29. Shih gjithashtu më lart, para. 18.

Procedurës Paraprake ta dëgjonte Parashtruesin para se të vendoste nëse ishte i përligjur apo jo paraburgimi i tij.[144] Për Dhomën, fakti që gjykatësi para të cilit u soll Parashtruesi pas arrestimit dhe transferimit të tij, ishte i njëjti gjykatës që lëshoi fletarrestimin dhe urdhrin për transferim, nuk e ndryshon zbatueshmërinë e këtyre parimeve.[145]

48. Dhoma rikujton se, në këtë çështje, në seancën e paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e informoi si duhet Parashtruesin për konstatimin e dyshimit të bazuar mirë se ai kishte kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, për akuzat ndaj tij të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar dhe për të drejtat e tij para DHS-së, si dhe e udhëzoi Parashtruesin të vetëdeklarohej në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tij.[146] Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e pyeti në mënyrë të qartë Parashtruesin nëse dëshironte të ngrinte ndonjë çështje "lidhur me arrestimin [e tij], transferimin në Hagë, apo kushtet e paraburgimit [të tij]",[147] duke i dhënë kështu mundësinë t'i paraqiste Gjykatësit të Procedurës Paraprake arsyet e mundshme personale kundër paraburgimit të tij. Në lidhje me këtë Dhoma vëren se, në kohën kur u pyet për këtë, Parashtruesi ishte informuar mjaftueshëm për arsyetimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në lidhje me themelësinë e paraburgimit të tij.[148] Megjithatë, në prani të mbrojtësit, Parashtruesi u përgjigj "jo, nuk kemi asgjë për të shtuar" dhe se "gjithçka [ishte] në rregull".[149]

49. Në mungesë të argumenteve nga Parashtruesi, Dhoma konstaton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mund të fajësohet që nuk hyri në hollësi të mëtejshme lidhur me rrethanat pro apo kundër paraburgimit të Parashtruesit. Ajo çka Dhoma e konstaton të rëndësishme është se Gjykatësi i Procedurës Paraprake i bëri pyetje

[144] Shih, për shembull, ECtHR, *Harkmann v. Estonia*, cituar më lart, paras 37-40.
[145] Shih, për ngjashmëri, ECtHR, *Abdulsitar Akgül v. Turkey*, cituar më lart, paras 5, 8, 20-21; *Kornev and Karpenko v. Ukraine*, cituar më lart, paras 11-12, 45-47; *Harkmann v. Estonia*, cituar më lart, paras 13-14, 16, 37-39.
[146] Shih më lart, para. 10.
[147] Shih më lart, para. 11.
[148] Shih më lart, para. 8.
[149] Shih më lart, para. 11.

Parashtruesit, i dha atij mundësinë të dëgjohej dhe u bind se ekzistonte dyshimi i bazuar mirë se ai kishte kryer një vepër penale brenda juridiksionit të DHS-së, përkatësisht se paraburgimi i Parashtruesit përfshihej në përjashtimin e lejuar të përcaktuar në nenin 5(1)(c) të Konventës. Duke pranuar se ligjshmëria dhe themelësia e vazhdimit të paraburgimit të Parashtruesit mund të ishin trajtuar më qartë, Dhoma është e mendimit se vendimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake,[150] ndonëse i shkurtër, nuk mund të trajtohet sikur nënkupton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i mori parasysh këto aspekte. Përkundrazi, duke mos marrë asnjë argument tjetër nga Parashtruesi që do të përligjte rivlerësimin e vendimit për arrestim dhe transferim, në rrethanat konkrete është e mjaftueshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi konstatimet e mëhershme të tij të bëra në vendimin për arrestim dhe transferim, dhe e kuptueshme që arsyet e përshkruara në të mbështetën në mënyrë të vetvetishme vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në seancën e paraqitjes së parë më 13 dhjetor 2023.

50. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se paraqitja e parë e Parashtruesit para Gjykatësit të Procedurës Paraprake më 13 dhjetor 2023 përmbushi kriteret e nenit 5(3) të Konventës.

C. PËRFUNDIM

51. Bazuar në sa më lart, Dhoma konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 5(3) të Konventës.

VIII. KËRKESAT SHOQËRUESE

52. Krahas ankesës së tij sipas nenit 5(3) të Konventës, Parashtruesi kërkoi gjithashtu që, pas konstatimit të shkeljes së nenit 5(3) të Konventës, Dhoma po kështu (i) të deklaronte të paligjshëm mbajtjen në paraburgim të Parashtruesit nga 13 dhjetori 2023 deri në datën e vendimit mbi rishikimin e paraburgimit më 9 shkurt 2024;[151] dhe (ii) të

[150] Shih më lart, para. 11.
[151] Kërkesa Referuese, para. 36(ii).

bënte të ditur se Parashtruesi mund t'i paraqiste Kryetares kërkesë për zhdëmtim ose për masë ndreqëse tjetër të përshtatshme, për periudhën gjatë së cilës u mbajt në paraburgim në mënyrë të paligjshme.[152]

53. Duke rikujtuar përfundimin e mësipërm të saj se në këtë çështje nuk ka pasur shkelje të nenit 5(3) i Konventës, Dhoma konstaton se, si rezultat, kërkesat shoqëruese të Parashtruesit janë të tejkaluara.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese njëzëri,

1. *Shpall* të pranueshme Kërkesën Referuese të z. Haxhi Shala;

2. *Konstaton* se nuk ka pasur shkelje të nenit 5(3) të Konventës; dhe

3. *Rrëzon* si të tejkaluar kërkesat shoqëruese të Parashtruesit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland

Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e enjte, 6 mars 2025
Në Hagë, Holandë

[152] Kërkesa Referuese, para. 36(iii).